



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AVOKATI I POPULLIT  
*Seksioni i Veçantë*



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2  
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315  
E-mail: [ap@avokatipopullit.gov.al](mailto:ap@avokatipopullit.gov.al)  
[www.avokatipopullit.gov.al](http://www.avokatipopullit.gov.al)

Nr. Prot.  
Nr. Dok. 201600130/8

Tiranë \_\_\_/\_\_\_/2016

**Lënda :** *Rekomandojmë marrjen e masave për shpjetimin e gjykimit të çështjes penale me Nr.3874 akti, datë 01.12.2015, me ankues B. A., me objekt lirim me kusht.*

**Drejtuar :** **Z. HYSNI DEMIRI**  
**Kryetar i Gjykatës së Apelit**

**TIRANË**

***I nderuar zoti Kryetar,***

Në ankesën e tij datë 01.02.2016, drejtuar institucionit të Avokatit të Popullit, **ankuesi B. A.** i dënuar me burgim në Institucionin e Veçantë të Ekzekutimit të Vendimeve Penale Krujë, ankohet ndaj vendimit me Nr.80 datë 15.10.2015 të Gjykatës Rrethit Gjyqësor Krujë, e cila ka vendosur rrëzimin e kërkesës tij me objekt lirim me kusht.

Ndaj këtij vendimi gjyqësor ankuesi B. A. është ankuar në Gjykatën e Apelit Tiranë, e cila nuk ka caktuar akoma datën dhe orën e gjykimit të saj duke mos patur parasysh kërkesat e nenit 42/2 të Kushtetutës së RSH për të drejtën e një gjykimit të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanëshme e caktuar me ligj.

Nga verifikimet tona rezulton se dosja e tij ndodhet për shqyrtim në Gjykatën e Apelit Tiranë, me Nr.3874 akti, datë 01.12.2015 dhe si gjyqtare relatore në bazë të shortit të hedhur është caktuar Zj.Valdete HOXHA.

Ankuesi B. A. nga ana e tij na shkruan se është i moshës 74 vjeç, ka vuajtur mbi 20 vjet burgim, se është në gjendje jo të mirë shëndetësore dhe ekonomike, dhe se ai me sjelljen dhe punën e tij tregon plotësisht se me dënimin e vuajtur deri tani i është arritur qëllimit për edukimin e tij.

Në këto kushte, institucioni i Avokatit të Popullit, duke analizuar të gjitha rrethanat e kësaj çështje gjyqësore, duke e konsideruar këtë ankesë **si një rast të veçantë**, menduam të ndërhyjmë pranë jush me anë rekomandimi për tu vlerësuar nga ana juaj mundësit ligjore të shpejtimit të këtij gjykimi në të ardhmen.

Kështu, kjo kërkesë e jona bazohet në nenin 63/3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ku thuhet se: "Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të marrë masa kur vëren shkelje të të drejtave të njeriut, nga administrata publike", dhe në kërkesat e nenit 25 të Ligjit Nr.155/2014 Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr.8454 datë 04.02.1999" Për Avokatin e

Popullit”, të ndryshuar ku thuhet se:”Avokati i Popullit pranon ankesa, kërkesa ose njoftime për shkelje të drejtave të njeriut, që rrjedhin nga administrata e pushtetit gjyqësor dhe ekzekutimi i vendimeve gjyqësore. Hetimi dhe kërkesa e Avokatit të Popullit nuk prekin pavarësinë e gjykatës në marrjen e vendimit”.

Për sa më sipër, ju

#### **REKOMANDIMË :**

1.Marrjen e masave për shpejtimin e gjykimit të çështjes penale me Nr.3874 akti, datë 01.12.2015 me ankues B. A., me objekt lirim me kusht.

2.Mbi masat e marra për shqyrtimin e rekomandimit nga ana juaj, lutemi të njoftohemi me shkrim brenda 30 ditëve.

*Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,*

**KOMISIONERI**

**Arben SHKËMBI**